



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2021:210176

Datë: 21.03.2024

Numri i dokumentit: 05482373

C.nr.822/21

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË MALISHEVË / Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, gjyqtarja Hatixhe Begaj, me bashkëpunëtorin profesional Liman Javori, në çështjen juridike të paditësve: F. M., Q. Th. dhe D. M., të punësuar pranë Shkollës Filllore të Mesme të Ulët SHFMU "Labinot Krasniqi" në Mirushë, Komuna e Malishevës, të cilët i përfaqëson avokat Zahir Hamza nga Prishtina, sipas autorizimeve në shkresat e lëndës, kundër të paditurës Komuna e Malishevës – Drejtoria Komunale e Arsimit, për shkak të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë - shujtave ditore, vlera e kontestit 666€, jashtë shqyrtimit me datë 21.03.2024 merr këtë:

A K T G J Y K I M
PËR SHKAK TË PADEGJUESHMËRISË (MOSBINDJES)

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësve: F. M., Q. Th. dhe D. M., të punësuar pranë Shkollës Filllore të Mesme të Ulët SHFMU "Labinot Krasniqi", në fshatin Mirushë, Komuna e Malishevës,

II. OBLIGOHET e paditura Komuna e Malishevës - Drejtoria Komunale për Arsim, që në emër të kompensimit për ushqim gjatë punës - shujtave ditore, t'ua paguajë paditësve si në vijim:

- Paditësit F. M., t'ia kompensojë *shumën në lartësi të përgjithshme prej 222,00 euro*, për 111 ditë nga 2 (dy) euro për secilën ditë të prezencës në punë, duke e llogaritur prej datës 01.01.2021 deri me datën 15.07.2021.
- Paditëses Q. Th., t'ia kompensojë *shumën në lartësi të përgjithshme prej 222,00 euro*, për 111 ditë nga 2 (dy) euro për secilën ditë të prezencës në punë, duke e llogaritur prej datës 01.01.2021 deri me datën 15.07.2021.
- Paditëses D. M., t'ia kompensojë *shumën në lartësi të përgjithshme prej 60,00 euro*, për 30 ditë nga 2 (dy) euro për secilën ditë të prezencës në punë, duke e llogaritur prej datës 01.01.2021 deri me datën 15.07.2021.

Të gjitha shumata e lartëcekura, detyrohet e paditura që paditësve të iu paguajë me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të filloi të llogaritet që nga dita e paraqitjes së padisë dt.11.08.2021, e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

III. REFUZOHET si e pabazuar pjesa e kërkesëpadisë për paditësen D. M., mbi shumën e aprovuar sikurse në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, konkretisht shuma prej 162€.

IV. DETYROHET e paditura Komuna e Malishevës - Drejtoria Komunale për Arsim që paditësve t'ua kompensojë shpenzimet e procedurës në shumën prej 228.00 euro, ndërsa pjesa tjetër e shpenzimeve të procedurës mbi shumën e aprovuar **REFUZHET**.

A r s y e t i m

Paditësit F. M., Q. Th. dhe D. M., të punësuar pranë Shkollës Fillore të Mesme të Ulët SHFMU "Labinot Krasniqi" në Mirushë, Komuna e Malishevës, të cilët i përfaqëson av. Zahir Hamza nga Prishtina, pranë kësaj gjykate kanë parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Malishevës – Drejtoria Komunale e Arsimit, me bazë juridike kompensim për shujtat ditore të paraparë me Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017, deklaruar që paditësit kërkojnë të paguhen në emër të shujtave ditore, për paditësin Fadil Morina, për periudhën nga 01.01.2021 deri më 15.07.2021 për 111 ditë pune shumën prej 222 euro, për paditësen Q. Th., për periudhën nga 01.01.2021 deri më 15.07.2021, për 111 ditë pune shumën prej 222 euro, për paditësen D. M., për periudhën nga 01.01.2021 deri më 15.07.2021, për 111 ditë pune shumën prej 222 euro, pra për secilin paditës shumën prej 2 euro, sipas vërtetimeve të lëshuara nga shkolla, në shumën e përgjithshme për të gjithë prej 666 euro, të gjitha këto me kamatë prej 8 % nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare. Shpenzimet procedurale i ka kërkuar në vlerën prej 312 €uro, në emër të përpilimit të padisë, si dhe 20 euro në emër të taksës për padi.

Në kuptim të nenit 394 të Ligjit për Procedurën Kontestimore gjykata me aktvendim C.nr.822/21 të datës 09.08.2023, e ka obliguar të paditurën që në afat prej 15 ditësh të jap përgjigje në padi, në të cilën duhet të deklarohet nëse e pranon apo e kundërshton kërkesëpadinë e paditësit, të paraqes faktet dhe provat që e vërtetojnë kundërshtimin e saj. Nga shkresat e lëndës, rezulton se aktvendimi i potencuar është pranuar nga pala e paditur me datë 25.08.2023 dhe gjerë më tani e paditura nuk ka parashtruar përgjigje në padi edhe pse gjykata me aktvendim për përgjigjen në padi i ka tërhequr vërejtjen se në rast të mos veprimit sipas këtij aktvendimi do të përballet me pasojat ligjore.

Gjykata, pasi i ka vlerësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mosbindjes, ka gjetur së në rastin konkret plotësohen të gjitha kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit në fjalë nga neni 150 paragrafi 1 pikat a), b) dhe (c) të LPK-së, nëse të paditurit i është dorëzuar padia dhe thirrja për përgjigje në padi, se themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi dhe se faktet në të cilat mbështetet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vetë paditësi apo me faktet e ditura botërisht.

Themelësia e kërkesëpadisë del nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, konkretisht nga vërtetimi me nr.prot.221/21 të datës 15.06.2021 për paditësen Q. Th., vërtetimi me nr.prot.206/21 të dt.15.06.2021 për paditësin F. M. dhe vërtetimi me nr.prot.212/21 i dt.15.06.2021 për paditësen D. M., të lëshuar nga Shkolla Fillore e Mesme e Ulët "Labinot Krasniqi" fshati Mirushë, Komuna e Malishevës, nga të cilat vërtetohet se paditësit janë në marrëdhënie pune të e paditura si mësimdhënës në këtë shkollë, si dhe nga të njëjtit vërtetohet vijueshmëria në punë e paditësve nga data 01.01.2021 deri me datën 15.07.2021, periudhë kjo për të cilën të gjithë paditësit e lartëcekur kërkojnë kompensimin e shujtave të ushqimit për 111 ditë pune për secilin, ndërsa se paditësit F. M. dhe Q. Th. kanë nga 111 ditë pune secili, ndërsa se paditësja D. M. ka 30 ditë pune, u vërtetua përmes vërtetimeve të lartëcekura, prova të cilave gjykata ia fali besimin e plotë duke u bazuar edhe në nenin 329.1, të LPK-së, në të cilin përcaktohet që "*Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e*

autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”, pasi janë lëshuar nga institucionet arsimore të së paditurës.

Sipas nenit 35 par.7 të Kontratës Kolektive e Arsimit të Kosovës, e datës 18.04.2017 dhe të datës 22.01.2021, është paraparë se: 35.7 *”Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë për një ditë pune është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënie e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restaurantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër nuk ka obligim kompensimin për ushqim”*. Sipas dispozitës në fjalë paditësve u takojnë shpenzimet e ushqimit.

Gjykata konsideron se kjo kontratë është marrëveshje e cila bazohet në Ligjin e Punës Nr.03/L-212, neni 90 par. 5 e që përcakton se *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”,* e që nënkupton detyrimin e punëdhënësit përkatësisht të paditurës për kompensimin e ushqimit për ditët e pranisë në punë, e njëjta e nënshkruar nga Ministria e Arsimit dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë që prodhon efekt juridik për punëdhënësit që kanë të punësuar, sepse të drejtat e tyre burojnë nga kjo kontratë dhe e paditura është punëdhënës i paditësve prandaj detyrohet për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga kjo kontratë.

Gjykata gjeti se kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e bazuar dhe vendosi si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, me arsyetimin se për periudhën prej datës 01.01.2021 e deri me datë 15.07.2021 paditësi F. M. ka gjithësej 111 ditë pune vërtetuar nga vërtetimi me nr.prot.206/21 si dhe paditësja Q. Th. ka gjithësej 111 ditë pune vërtetuar nga vërtetimi me nr.prot 221/21, dhe secilit prej tyre iu takojnë shpenzime të ushqimit për çdo ditë pune nga 2€uro (111 x 2=222.00€uro) e që është shuma prej 222.00 €uro për paditësin F. M. dhe Q.Th.i. Ndërsa për paditësen D. M. u vërtetua se e njëjta ka gjithësej 30 ditë pune për periudhën 01.01.2021 deri më 15.07.2021 e që i takojnë shpenzimet e ushqimit për çdo ditë pune nga 2 euro (30 x 2= 60euro). Në rastin konkret gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditësve t’iu paguaj shpenzimet e ushqimit (shujtave) në punë.

Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke e refuzuar si të pabazuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditëses D. M. mbi shumën e aprovuar sikurse në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, konkretisht shumën prej 162€, pasi që paditësja në fjalë ka kërkuar kompensimin për 111 ditë pune në shumën prej 222 euro, ndërsa nga vërtetimi me nr.prot.212/21 të dt.15.06.2021 të lëshuar nga SHFMU “Labinot Krasniqi” në Mirushë Komuna e Malishevës, vërtetohet se paditësja ka pasur 30 ditë pune për periudhën 01.01.2021 deri më 15.07.2021, andaj të njëjtës i takojnë 60 euro në emër të shujtës ditore.

Për kamatën gjykata ka vendosur duke u mbështetur në dispozitën e nenit 382 të LMD-së dhe Mendimit Juridike të Gjykatës Supreme të Kosovës për kamatën nr.265/2020 të datës 01.12.2020, ka marr datën e ushtrimit të padisë (data 11.08.2021), e ku lartësia e kamatës vjetor është e definuar 8% deri në pagesën definitive.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452 të LPK-së, lartësia e shpenzimeve i referohet shumës prej 208 euro për përpilim padie dhe për taksë gjyqësore në shumën prej 20 euro, ndërsa shuma mbi vlerën e aprovuar për padi, konkretisht shuma prej 104 euro për përpilimin e padis është refuzuar duke u bazuar në Rregulloren për Tarifën e Odës së Avokatëve numri tarifor 6.

Gjykata, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke i'u referuar dispozitës së nenit 150 par.1 pika a, b, dhe c të LPK-së, e në lidhje me dispozitat e nenit 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 18.04.2021 dhe 22.01.2021, dhe dispozitave të nenit 245 par.1 dhe 2, neni 249 par.1 dhe 2 të LMD-së.

GJYKATA THEMELORË NË GJAKOVË- DEGA NË MALISHEVË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.822/21, dt.21.03.2024

Gjyqtarja
Hatixhe Begaj

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 (shtatë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa paraqitet nëpërmjet kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.